



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 106 datë 27. 12. 2022



“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BUXHETIT VENDOR PËR FAMILJET DHE INDIVIDET NË NEVOJË QË REZULTOJNË ME PIKË TË PAMJAFTUESHME NGA SISTEMI I PIKËZIMIT PËR VITIN 2023”

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore ” neni 21 të Ligjit, Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit, Nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat dhe Vetëqeverisjen Vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të Buxhetit Vendor , si më poshtë:
 - 1.1.Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
 - 1.2. Do të përzgjidhen ata aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
 - 1.3 Prioritet do të kenë familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar:
 - a. familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë,
 - b. familje që në përbërje të tyre kanë të mitur në konflikt me ligjin,
 - c. vajza/gra kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim,
 - d. kryefamiljar që me vendim gjykate kanë në ngarkim fëmijë të mitur,
 - e. Kryefamiljarë/e me moshë mbi 50 vjeç që rezultojnë të papunë,
 - f. Familje të cilat sigurojnë të ardhura të pamjaftueshme dhe në përbërje të tyre kanë të mitur.
 - 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë), si dhe Drejtoria e Financës.
 - 3- Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT

ETLEVA YZO

KRYETAR I KËSHILLIT

LAVDI HASANI